



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS/ TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

KPK/Nr. 510 /2017
Datë: 9 tetor 2017

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 paragrafi 1.26 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në bazë të nenit 8 Rregullores Nr. 02/2015 për Zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 2 të Rregullores Nr.06/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2015 për Zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në takimin e mbajtur më 9 tetor 2017, mori këtë:

VENDIM

I. Themelohet Komisioni Zgjedhor i Këshillit Prokurorial të Kosovës për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit, në këtë përbërje:

1. Arben Ismajli, Kryesues;
2. Sevdije Morina, anëtare dhe
3. Valdrin Krasniqi, anëtar;

II. Anëtarë rezervë të Komisionit Zgjedhor të Këshillit Prokurorial të Kosovës për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarin e Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit, janë:

1. Radica Milić;
2. Lulzim Sulejmani, dhe
3. Saranda Sokoli - Berisha;

III. Obligohet Komisioni Zgjedhor që veprimtarinë e tij ta ushtrojë në bazë të Rregullores Nr. 02/2015 për Zgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

IV. Obligohet Sekretariati për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të KPK-së.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Blerim Isufaj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit;
- Arkivit të KPK-së.

